



RAPORTI I EKSPERTIT KONTABËL TË REGJISTRUAR

Për auditimin ligjor të fondeve të përfituara dhe të shpenzuara nga
Partia "Aleanca e Maqedonsve per Integrimin European" A.M.I.E

Fushata zgjedhore 2015
Periudha 21/05/2015 - 19/06/2015



RAPORTI I EKSPERTIT KONTABËL TË REGJISTRUAR
KOMISIONIT QENDROR TË ZGJEDHJEVE
TIRANË

Të nderuar zotërinj!

Në cilësinë e Ekspertes Kontabël të Regjistruar, bazuar në vendimin numër 969, dt.10.08.2015, të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve si dhe të kontratës të shërbimit lidhur me të me numër protokollit të sajin 7703, datë 29.09.2015, kam audituar pasqyrat që lidhen me financimin e fondeve të përftuara dhe të shpenzuara për fushatën zgjedhore për organet qeverisjes vendore, që fillon me datë 21.05.2015 me regjistrimin e Partisë “Aleanca e Maqedonsve per Integrimin European” (A.M.I.E) në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve (si subjekt zgjedhor) dhe mbyllet me datë 19.06.2015 me përfundimin e fushatës zgjedhore të datës 21 qershor 2015.

Përgatitja e këtyre pasqyrave është përgjegjësi e drejtuesve të partisë “Aleanca e Maqedonsve per Integrimin European” (A.M.I.E). Detyra e subjektit zgjedhor është të përgatisë pasqyrat mbi bazën e arkëttimeve dhe pagesave.

Përgjegjësia ime është të shpreh një opinion mbi këto pasqyra bazuar në auditimin e kryer. Auditimi u krye në zbatim të kërkesave të Standarteve Ndërkombetare të Auditimit, në referencë të veçantë me SNA-në 800: “Auditimet e pasqyrave financiare të përgatitura sipas kuadrove për qëllime specifike”.

Këto standarte kërkojnë që unë të planifikoj dhe të kryej auditimin për të zotëruar siguri të arsyeshme se këto pasqyra nuk përmbajnë anomali materiale. Auditimi përfshin shqyrtimin, mbi bazën e testeve, të fakteve që mbështesin shumat dhe deklaratimet në pasqyrat financiare që përfshijnë: librin e llogarive të subjektit, regjistrin e posaçëm të miratuar si model me vendim nr.266 të KQZ-së, dt.01.06.2009 si dhe pasqyrën e arketim pagesave.



Auditimi përfshin gjithashtu, vlerësimin e parimeve të kontabilitetit të ndjekura dhe vlerësimet e rëndësishme të bëra nga drejtimi, si edhe vlerësimin e paraqitjes së përgjithshme të pasqyrës.

Unë çmoj se evidenca e auditimit që kam siguruar është e mjaftueshme dhe e përshtatshme për të dhënë një bazë për opinionin tim të auditimit.

Për mendimin tim, pasqyrat bashkëlidhur dt.19.06.2015 e fondeve të përfituara dhe të shpenzuara për fushatën zgjedhore të Partisë "Aleanca e Maqedonsve per Integrimin European" (A.M.I.E) që fillon me dt.21.05.2015 dhe mbyllet me dt.19.06.2015 është përgatitur në të gjitha aspektet materiale, në përputhje me kërkesat e raportimit mbi bazën e arkëtive dhe të pagesave, konform ligjit nr.9228 dt.29.04.2004 "Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare", i ndryshuar.

Bashkëlidhur dokumentet përkatëse.

HIDAJETE KRAJA (MUÇAJ)

EKSPERTE KONTABËL E REGJISTRUAR

Shkodër, më 10.12.2015